

BAZAT E AVANCUARA TË TË DHËNAVE

ECDL / ICDL Bazat e Avancuara të të dhënave është një program certifikues i nivelit të lartë, i cili ju mundëson kandidatëve përfitimin e shkathtësive të reja, në përdorimin e veglave të avancuara të cilat do t'i kenë në dispozicion për aplikacionet e databazave, për të menaxhuar dhe organizuar sa më mirë informacionin e strukturuar.

Kandidatët e certifikuar me modulën e avancuar të ECDL / ICDL Bazat e të dhënave mund të:

- Përpilojnë raporte më të detajuara, me analizë më të thellë të të dhënave
- Krijojnë informacione menaxheriale të cilësisë më të lartë
- Përdorin funksione të avancuara gjatë përpilimit të tabelave, pyetësorëve si dhe gjatë dizajnit të formave dhe raporteve të ndryshme
- Përdorin macros në kuadër të aplikacioneve të bazës së të dhënave
- Importojnë, eksportojnë dhe bëjnë lidhjen e të dhënave

UDHËZIMET PËR KËTË MODUL SUGJEROJNË 30 ORË MËSIM PARA SE KANDIDATI TI NËNSHTROHET TESTIMIT.

KUJT I DEDIKOHET KY MODUL?

Kandidatët e ardhshëm potencial duhet të kenë certifikimin ECDL / ICDL ose përvojë të mëparshme të përdorimit të kompjuterëve dhe aplikacioneve softuerike. Në mënyrë të veçantë, këta do të jenë individë të cilët përdorin një gamë të gjerë të funksioneve të avancuara brenda një aplikacioni nga Baza e të dhënave si për përdorim personal ashtu edhe atë profesional. Aplikacionet e Bazave të të dhënave janë një burim i fuqishëm, për të menaxhuar dhe analizuar vëllime të larta të të dhënave, si dhe për të prodhuar informacione në sasinë dhe cilësinë që sot kërkon biznesi. Certifikata ECDL / ICDL Bazat e Avancuara të të dhënave është projektuar veçanërisht për të pajisur kandidatët me aftësitë dhe kompetencat që ju mundësojnë atyre përdorimin e aplikacioneve të Bazave të të dhënave për përmbushjen e plotë të potencialeve të tyre.

Për të mësuar më shumë në lidhje me këtë modul mësimor dhe materialeve trajnuese si dhe për të gjetur qendrën tuaj më të afërt të akredituar, ju lutemi vizitoni www.ecdl-kosova.org



Certifikatat e lëshuara nga ECDL Kosova vlejnë ndërkombëtarisht.